



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT

PËR

MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË

MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë, Shtator 2018

RAPORT

Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrit nr. 85, datë 9.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 3, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrit më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Alda Xhaxhiu dhe Gentiana Biku, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i cili filloi në datën 05.02.2018.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislacionit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim:

hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, janë përpunuar të dhënat dhe është përgatitur raporti i monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me përmbajtjen që do të analizohet në vijim.

Qëllimi i monitorimit

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e monitorimit

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim, në datën 05.02.2018, me ******, me detyrë “Drejtor” i Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, me të cilën u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhet të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësja ******, e cila kryen detyrën “Përgjegjës Sektor” në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listëprezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përshkimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

Përmbajtja e Raportit:

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, rezulton se është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror. Nga ky proces, u shkrinë 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave iu bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin para zgjedhjeve, në 13 ministri.

Për pasojë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila është subjekt i këtij monitorimi, si dhe gjithë ministrinë e tjera, kaluan në proces ristrukturimi.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

I. Analiza e Procesit të Ristrukturimit

Me konstituimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, pas procesit zgjedhor (*Qershor, viti 2017*), u miratuan, aktet nënligjore që përcaktojnë fushën e përgjegjësisë së ministrive të linjës.

Në lidhje me veprimtarinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka dalë vendimin nr. 503, datë 13.09.2017, "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*", është miratuar misioni dhe fusha e përgjegjësisë shtetërore e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke shfuqizuar Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 841, datë 27.09.2013 "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave*" dhe nr. 835, datë 18.09.2013 "*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*", i ndryshuar.

Më tej, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*", është miratuar struktura dhe organika e re, sipas skemës 1 e 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

i. Situata e konstatuar në institucion

Mbi bazën e akteve të mësipërme, konstatohet se funksionet dhe struktura e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Financave dhe 2 Drejtori nga Ministria e Mirëqenies Sociale, janë përfshirë në strukturën dhe funksionet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky fakt reflektohet në pikën III të këtij akti nënligjor, "*Veprimtaria e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë*" dhe në pikën IV të këtij akti, ku janë të përcaktuar përgjegjësitë e këtij institucioni.

Në këto kushte, në kuptim të udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, "*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*", i ndryshuar, arrihet

në konkluzionin se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka kaluar në një proces riorganizimi dhe ristrukturimi, për shkak të ndryshimit të misionit dhe mënyrës së organizimit të institucionit.

Gjatë procesit të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka funksionuar struktura dhe organika e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”, për këtë arsye janë marrë në shqyrtim, nëpunësit civil të *Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Drejtoria e Politikave për ish të Përndjekurit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*.

Nisur nga struktura organizative, rezulton se numri i stafit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është **336** punonjës nga të cilët **297** nëpunës civilë, kundrejt **509** punonjësve, nga të cilët **449** nëpunës civilë që kanë qenë në ministritë përkatëse të bashkuara tashmë në institucionin në fjalë.

Struktura e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, aktualisht është e organizuar në **8** shtylla kryesore që janë Drejtoritë e Përgjithshme, në varësi të të cilave janë drejtoritë përkatëse.

Në vijim të këtij arsytimi, është marrë në analizë struktura paraardhëse e Ministrive të cilat janë përfshirë në procesin e ristrukturimit dhe në mënyrë të detajuar situata paraqitet si më poshtë:

➤ ***Ministria e Financave (329 punonjës)***

Ky institucion funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 8, datë 31.01.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave*”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur **293** pozicione pune si pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Financave, ndahen në këtë mënyrë:

- ✓ *Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues*, **8** pozicione pune, 3% e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - 1 “*Sekretar i Përgjithshëm*”
 - 7 “*Drejtor i Përgjithshëm*”,
- ✓ *Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues*, **29** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”, rreth **10 %** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **58** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”, rreth **20%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, **198** pozicione pune, **67%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - 189 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
 - 7 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,
 - 2 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,

➤ **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (151 punonjës)**

Ky institucion funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 106, datë 24.06.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 136, datë 23.08.2016. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur **127** pozicione pune të organizuara në shërbimin civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e këtyre pozicioneve sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, këto pozicione grupohen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, **6** pozicione pune, **5%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”
 - 5 “Drejtor i Përgjithshëm”,
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, **14** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **11%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **36** pozicione pune, **28%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - 22 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
 - 2 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,
 - 12 “Përgjegjës Dege” në Rrethe
- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, **71** pozicione pune, **56%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - 68 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
 - 3 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,

- **Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit Arsimi dhe Formimit Profesional (24) dhe Drejtoria e Politikave për ish të Përndjekurit (5) nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (si edhe 3 Institucione varësie : AKAFPK, ISHPSH, SHP (së bashku me degët rajonale)**

Këto njësi organizative kanë qenë pjesë e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 40, datë 23.03.2015, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur gjithsej **116** punonjës nga të cilët, **29** pozicione pune që vlerësohen si pjesë e shërbimit civil, i janë bashkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, këto pozicione grupohen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, 1 pozicion pune, që i përket pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm”, rreth **3%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, 5 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **17 %** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, 2 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”, rreth **7%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, 21 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve “Specialist/kategoria e pagës III/b”, rreth **73 %** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- **Situata pas ristrukturimit dhe përfshirjes së 3 ministrive të mësipërme në strukturën e institucionit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, paraqitet si më poshtë:**

Aktualisht, ky institucion funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, në momentin e verifikimit ka gjithsej **336** pozicione pune, nga të cilat,

- 16 pozicione pune janë funksione politike;
- 23 pozicione pune janë funksione mbështetëse;

- **297** pozicione pune vlerësohen si pjesë e shërbimit civil (të cilat zënë rreth **88%** të numrit total të pozicioneve të punës).

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, këto pozicione grupohen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, **9** pozicione pune, rreth **3%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil të cilat i përkasin pozicioneve
 - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”
 - 8 “Drejtor i Përgjithshëm”,
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, **31** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **10%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **72** pozicione pune, rreth **25%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil, të cilat i përkasin pozicioneve
 - **70** “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
 - **2** “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,
- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, **185** pozicione pune, rreth **62%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil të cilat i përkasin pozicioneve
 - 180 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
 - 4 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,
 - 1 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,

Për sa më sipër, grupi i punës arrin në konkluzionin se, miratimi i strukturës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është shoqëruar me ristrukturim të institucionit, pasi ka ndryshim të misionit të tij, shtesë të pozicioneve të punës, riorganizim të njërive organizative të pozicioneve të punës, etj.

iii Procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Baza ligjore mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II, i vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Nisur nga përmbajtja e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, rezulton se është Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, është subjekti që drejton gjithë procesin e ristrukturimit nga ana ligjore.

Gjatë procesit të monitorimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, u kërkua dokumentacioni përkatës, i cili ka të bëjë me faza të ndryshme të procesit të ristrukturimit, ndër të cilat:

a) Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit

Në zbatim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se për fillimin e procedurës së ristrukturimit, është bërë nga njësia përgjegjëse (DAP), njoftimi individual për nëpunësit civil të 3 institucioneve të përfshira në proces, në datën 13.09.2017.

b) Komisioni i Ristrukturimit

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP), është nxjerrë akti për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, me Urdhrin nr. 112/2 datë 09.10.2017, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, njoftuar institucionit me aktin nr. 5974/1 datë 10.10.2017, me përbërjen si vijon:

- Punonjësja ***** , *Specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike – kryetar;*
- Punonjësja ***** , *Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, - anëtar;*
- Punonjësja ***** , *Përgjegjës Sektori, në Ministrinë e Financave - anëtar*

Duke analizuar strukturën dhe organikën e re të miratuar, si dhe strukturat dhe organikat e mëparshme të 3 ministrive të bashkuara, konstatohet se nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, është shqyrtuar mundësia e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, brenda institucionit, si dhe në institucionet e varësisë.

Në realizimin e këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimi ka marrë parasysh përputhshmërinë e të dhënave individuale të nëpunësve me kërkesat e posaçme të vendeve të punës të ristrukturuar apo të krijuar, si dhe vjetërsinë në punë në pozicionin aktual, kjo e bazuar në kriteret specifike të dërguara nga institucionet me kërkesën e DAP, pasi përshkrimet e vendeve të jeja të punës, ende nuk kishin përfunduar sipas të gjitha rubrikave që përmban formulari i miratuar në aktin nënligjor.

Rezulton se në asnjë rast nuk është refuzuar vendimi përfundimtar i transferimit në kuadër të ristrukturimit, ç'ka provohet me aktet e miratimit për të vijuar marrëdhënien e punës në pozicionet e krijuara pas ristrukturimit, të administruara në dosjet personale të punonjësve.

Gjithashtu, rezulton se në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nuk është konstatuar asnjë rast i lirimit nga detyra për shkak të ristrukturimit.

c) Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit së aplikuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit.

Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t'u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit. (pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016). Rezulton se ky afat është respektuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionit në ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas përcaktimeve të pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërteton parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohej nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (sipas pikës 20 e 21 të kreut

II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij relacioni, rezulton se, ristrukturimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është bërë me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”. Komisioni i ristrukturimit është ngritur në datën 09.10.2017. Procedurat e sistemimit të nëpunësve nëpërmjet transferimit të përhershëm; nxjerrja e akteve të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit; si dhe, njoftimi i nëpunësve përkatës pozicionet e të cilëve u prekën nga ristrukturimi kanë përfunduar në datën 29.12.2018. (*Ashtu si është analizuar më sipër procedura është realizuar për një afat prej 80 ditësh kalendarike*).

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme. Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtjen e këtij relacioni, rezulton se ndodhemi në kushtet e reformim rrënjësor të aparatit shtetëror, shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre, si dhe riformatim konceptual të njësive organizative të institucioneve, ç`ka vlerësohet si një arsye objektive që përligj nevojën për një afat më të gjatë kohor, për realizimin e procedurës së ristrukturimit në fjalë.

Për më tepër, rasti i institucionit të monitoruar (MFE), i përket atyre institucioneve me një numër relativisht të lartë të punonjësve që janë analizuar në mënyrë nominale dhe të specifikave të veçanta të pozicioneve të punës, të cilat kërkojnë kohë për tu shqyrtuar gjatë procesit të ristrukturimit, ç`ka e justifikon faktin që afati i procesit i ka tejkaluar disa ditë kalendarike, deri në finalizimin e tij.

d) Përshkrimet e punës

Nisur nga përmbajtja e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, Komisioni i Ristrukturimit shqyrton mundësinë e sistemimit apo transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në vendet e lira apo të reja të krijuara, mbështetur në analizën e kriterëve specifike të pozicioneve të punës dhe të dhënave të nëpunësve civilë.

Në zbatim të Kreut IV, pika 13, germa “ç”, të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, kërkesat e veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil, përcaktohen tek përshkrimet e punës.

Më tej në pikën 14, të po këtij akti nënligjor, përcaktohet se: *“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”*.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, administrata e institucionit të mbikëqyrur ka kaluar në proces ristrukturimi. Në këtë kuadër konstatohet ndryshim i misionit të institucionit, shkrirje e bashkim i strukturave, shtim dhe riorganizim i pozicioneve të punës, etj., ç`ka nënkupton që ky proces ristrukturimi, duhej të paraprihej nga hartimi i përshkrimeve të reja të punës. Por, në rastin konkret vërehet se në këtë drejtim nuk është punuar sipas formatit të përcaktuar në aktin nënligjor që rregullon këtë aspekt të procesit.

Konkretisht, rezulton se, Departamenti i Administratës Publike në momentin e fillimit të procedurës së ristrukturimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar nëpërmjet postës elektronike, dërgimin e kriterëve të posaçme të pozicioneve të shërbimit civil, sipas strukturës organizative të ministrisë në fjalë, të cilat i janë vënë në dispozicion. Nga verifikimi, rezulton se nga ana e institucioneve janë përcaktuar sidomos kërkesat në lidhje me *përvojën në punë dhe kriterin arsimor*.

Pra, në momentin e ristrukturimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë qenë të përfunduara formularët e përshkrimit të punës, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore (*të cilat aktualisht janë në fazën e hartimit dhe të nënshkrimit të tyre*).

Grupi i punës këtë rast e vlerëson si parregullsi në administrimin e shërbimit civil, për arsye se ligji specifik që rregullon këtë aspekt kërkon që procesi i hartimit të përshkrimeve të punës duhet të përfundojë përpara se të fillojë procesi ristrukturimit.

Por nga ana tjetër, konstatohet se për të gjitha rastet, janë ekstraktuar kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune, sipas kushteve të reja të krijuara, të cilat i kanë krijuar mundësinë Komisionit të Ristrukturimit për të vlerësuar përmbushjen e tyre nga punonjësit aktual.

Përshkrimet e reja të punës, duke vlerësuar kompleksitetin e procesit, kërkojnë një angazhim të madh nga aktorët e ngarkuar prej ligjit për të hartuar këto akte, *të cilët fillimisht duhet të pozicionohen në këto vende në rolin e eprorit direkt*.

Në këtë rast, vlerësohet se kjo parregullsi është krijuar për rrethana objektive dhe nuk është e asaj natyre që të cenojë gjithë procesin, për arsye se informacioni bazë për të realizuar procesin e ristrukturimit, i tillë si detyrat organike dhe kriteret e veçanta që kërkohen për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil, rezulton se ishin përcaktuar përpara se procesi i ristrukturimit të fillonte.

Kjo problematikë është evidentuar nga Komisioneri në këtë rast, në mënyrë që të përfundojnë përshkrimet e punës dhe në të ardhmen, aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të marrin masa që të paraprijnë procesin e ristrukturimit me përshkrimet e punës.

e) Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit

Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur nga njësia përgjegjëse, DAP, pasi ka marrë në shqyrtim strukturat dhe organikat ekzistuese të ministrive të bashkuara, strukturën dhe organikën e re të MFE, të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e restrukturimit (*dosjet individuale*), kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara/prekura si pasojë e restrukturimit, ka vlerësuar mundësitë për transferimin e përhershëm të **318** nëpunësve civilë në strukturat organizative të MFE për të cilat nuk ka ndryshime dhe i ka dërguar propozimet përkatëse DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, me aktet nr. 6846, datë 04.12.2017; nr. 6846/198, datë 19.12.2017, nr. 6846/265, datë 26.12.2017 dhe nr 6846/294, datë 29.12.2017.

Në rastin konkret është vepruar si më poshtë:

- ✓ Për **201** nëpunës civilë të MF, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e re të MFE, që në këtë rast është institucioni ku nëpunësi civil ishte i emëruar (*është vepruar sipas precedencës së përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).
 - Për **10** nëpunës të MF, është bërë transferimi i përhershëm në strukturat e Institucioneve të varësisë të MFE.
- ✓ Për **58** nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e re të MFE, që në këtë rast, është institucioni që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi (*sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).
 - Për **6** nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës;
 - Për **1** nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Për **1** nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
 - Për **15** nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturat e Institucioneve të varësisë të MFE.
- ✓ Për **12** nëpunës të MMRS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e re të MFE, që në këtë rast, është institucioni që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi (*sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).
 - Për **1** nëpunës të MMRS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Brendshme;
 - Për **7** nëpunës të MMRS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Shëndetësisë;
 - Për **2** nëpunës të MMRS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturën e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

- Për 4 nëpunës të MZHETS, është bërë transferimi i përhershëm në strukturat e Institucioneve të varësisë të MFE.

f) Rastet me ulje në kategori sipas klasifikimit të pozicioneve në shërbimin civil, të konstatuara:

Nga verifikimi i praktikës së ristrukturimit, rezulton se në disa raste punonjësit janë pozicionuar në pozicione të një kategorie ose niveli me të ulët të shërbimit civil, të cilën në mënyrë të detajuar po e paraqesim si më poshtë:

✓ ***Nga Ministria e Financave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:***

1. ***** - transferim i përhershëm nga pozicioni Përgjegjës Sektori III- a/1, në specialist IV-b;
2. ***** - transferim i përhershëm nga Drejtor, II-b, në Përgjegjës Sektori, III-a/1;
3. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori III- a, në specialist III-b;
4. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori III - a, në specialist III-b;
5. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori III- a, në specialist III-b.

✓ ***Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë***

1. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori, kategoria e pagës III-a, në specialist, III-b;
2. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori, kategoria e pagës III-a, në specialist III-b;
3. ***** - transferim i përhershëm nga Drejtor, kategoria e pagës II-b, në Përgjegjës dege III-b;
4. ***** - transferim i përhershëm nga Drejtor , kategoria e pagës II-b, në Përgjegjës sektori III-a;
5. ***** - transferim i përhershëm nga Përgjegjës Sektori, kategoria e pagës III-a, në specialist III-b.

✓ ***Nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë***

1. ***** - transferim i përhershëm nga Drejtor, kategoria e pagës II-b, në Përgjegjës sektori III-a
2. ***** - transferim i përhershëm nga Drejtor, kategoria e pagës II-b, në Përgjegjës sektori, III-a

Në këto raste, nëpunësit në mënyrë shkresore kanë dhënë miratimin e tyre për transferimin dhe nuk ka asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit të nëpunësve, si rezultat i ristrukturimit, sikurse parashikohet në dispozitat ligjore. Vendimi përfundimtar i marrë nga njësia përgjegjëse, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, si dhe deklarata e nëpunësit të transferuar që shpreh miratimin për transferimin, janë të administruara në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil.

ç) Trupa e Nëpunësve Civile të Nivelit të Lartë Drejtues

Në lidhje me nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të lartë drejtues (*anëtar TND*), vërehet se, këta nëpunës nuk janë përfshirë në procesin e vlerësimit nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, kjo për shkak të regjimit dhe statusit të posaçëm që gëzojnë ata, si anëtarë të TND-së. Në nenet 27 - 32, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në Kreun VII, pika 3 dhe 5, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND*”, përcaktohet se, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, është organi kompetent i cili bën emërimin dhe lirimimin e anëtarëve të TND-së, nga një pozicion i rregullt i nivelit të lartë drejtues.

Nga analiza e të strukturave të ministrive të bashkuara rezultojnë të jenë **12** anëtarë të TND, nga **15** pozicione të Trupës së Nëpunësve Civile të Nivelit të Lartë drejtues (TND) (*pasi 3 ishin vende të lira*).

Aktualisht, duke ju referuar strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 161, datë 05.10.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*”, rezulton të jenë **9** pozicione pune që i përkasin kategorisë TND.

Për sa më sipër dhe nga analiza e dokumentacionit të administruar në institucion, njësia përgjegjëse në kuadër të ristrukturimit të institucionit të mbikëqyrur, për punonjësit e mësipërm ka vepruar si më poshtë:

✓ *Situata e TND para ristrukturimit:*

- *Ministria e Financave*
Nga **8** pozicione pune anëtarë të trupës së Nivelit të lartë Drejtues, **7** pozicione kanë qenë të zëna dhe **1** pozicion vend i lirë;
- *Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes*
Nga **6** pozicione pune që i përkasin TND, **4** pozicione pune kanë qenë të zëna dhe 2 vende vakante;
- *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*

1 pozicion që i përket TND ka qenë pozicion i zënë.

✓ Situata e TND pas ristrukturimit

Sa më sipër, duke qenë se numri i pozicioneve të TND në strukturën pas ristrukturimit është më i vogël (9) nga numri i pozicioneve që ishte më parë (15), Njësia përgjegjëse (DAP) duke ju referuar pikës 3, 4, 5, 6 dhe 7 të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, sipas kërkesës së titullarëve të institucioneve respektive, ka bërë emërimin në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, ose në pamundësi të sistemit, i ka regjistruar në listën e anëtarëve të TND në pritje, për t’u caktuar në një pozicion të rregullt.

Përfundimisht, situata pas ristrukturimit paraqitet si më poshtë në mënyrë analitike për çdo punonjës anëtar i TND :

- *Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes*

1. ***** , “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes, është emëruar nga DAP në një pozicion të rregullt “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës.
2. ***** , Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tregut të Brendshëm dhe Sipërmarrjes në MZHETS, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit për anëtar të TND, në datë 30.05.2016.

Me aktin nr. 7224/2, datë 12.01.2018 të DAP, “Lirim nga pozicioni i rregullt i anëtarit të TND”, është liruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, nga pozicioni i rregullt i Drejtorit të Përgjithshëm dhe është regjistruar në listën e anëtarëve të TND në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt.

3. ***** , emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit në datën 31.10.2013, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në MZHETS. Ky punonjës ka përfituar nga neni 67 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe është pjesë e anëtarëve të TND.

Me aktin nr. 7228/2, datë 29.12.2017 të DAP, “Emërim në pozicion të rregullt të anëtarit të TND”, është liruar nga pozicioni i mësipërm dhe është emëruar nga DAP, në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të rregullt Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike në MFE.

4. ***** , Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik & Integritimit, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit për anëtar të TND, në datën 06.01.2017.

Me aktin nr. 7229/2 datë 12.01.2018 të DAP, “Lirim nga pozicioni i rregullt i anëtarit të TND”, është liruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, nga pozicioni i rregullt i Drejtorit të Përgjithshëm dhe është regjistruar në listën e anëtarëve të TND në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt.

- *Ministria e Financave*

1. *****, emëruar në pozicion të rregullt TND “Sekretar i Përgjithshëm”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
2. *****, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë, emëruar pas pezullimit nga detyra, (ka qenë në listën e pritjes si Drejtor i Përgjithshëm).
3. *****, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MF.

Ka përfituar statusin e nëpunësit civil në TND, për shkak të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe është pjesë e anëtarëve të TND. Me aktin nr. 7283/2, datë 29.12.2017, të DAP, “Emërim në pozicion të rregullt të anëtarit të TND”, është emëruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të rregullt Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE.

4. *****, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MF. Ka përfituar nga neni 67, i Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe është pjesë e anëtarëve të TND.

Me aktin nr. 7227/2, datë 29.12.2017 të DAP, “Emërim në pozicion të rregullt të anëtarit të TND”, është emëruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të rregullt, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

5. *****, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë në MF, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit për anëtar të TND.

Me aktin nr. 7225/2, datë 12.01.2018, të DAP, “Lirim nga pozicioni i rregullt i anëtarit të TND”, është liruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, nga pozicioni i rregullt i Drejtorit të Përgjithshëm dhe është regjistruar në listën e anëtarëve të TND në pritje për t’u caktuar në një pozicion të rregullt.

6. *****, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MF. Ka përfituar nga neni 67, i Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe është pjesë e TND.

Me aktin nr. 7226/2, datë 29.12.2017, të DAP, “*Emërim në pozicion të rregullt të anëtarit të TND*”, është emëruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të rregullt Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik.

7. ******, emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike dhe të Çështjeve Fiskale në MF. Ka përfituar statusin TND, për shkak të nenit 67, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe është pjesë e TND.

Me aktin nr. 7223/2 datë 29.12.2017 të DAP, “*Emërim në pozicion të rregullt të anëtarit të TND*”, është emëruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të rregullt Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit.

- *Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*

1. Punonjësja ******, është emëruar sipas procedurave të rregullta të konkurrimit në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Punësimit dhe Arsimit Profesional në MMSR. Punonjësja ka përfituar statusin TND, për shkak të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe është pjesë e TND.

Me aktin nr. 7248/2, datë 29.12.2017, të DAP, pas kërkesës së Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18950, datë 21.12.2017 “*Kërkesë për emërim të një anëtarit të TND në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues*”, është emëruar nga DAP në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në pozicion të nivelit të mesëm drejtues, Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësisimit Profesional në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Makroekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit.

- g) *Ankesat drejtuar Komisionerit dhe organeve të përcaktuara nga ligji për të zhvilluar procesin e ristrukturimit.*

Gjatë analizës së dokumentacionit, të vënë në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga materialet e administruara pranë DAP, rezultoi të jenë **10** ankesa drejtuar institucionit të MFE dhe Komisionit të Ristrukturimit, nga të cilat në **9** raste është kthyer përgjigje në rrugë administrative, ndërsa në 1 rast, çështja është duke u zgjidhur nga gjykata.

Më poshtë po i analizojmë në mënyrë nominale këto raste.

➤ *Ankesat drejtuar Komisionerit*

1. Punonjësja ******, ka paraqitur pranë Komisionerit një ankesë fillimisht në datën 06.02.2018, e më tej, i është drejtuar përsëri me ankesën e datës 09.03.2018, me objekt “*Transferimin për shkak të ristrukturimit në shkelje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*” i ndryshuar, me pretendimin se i është ndërprerë

marrëdhënia financiare nga Ministria e Financave, për një periudhë kohore të lidhur me datën që i është lidhur kjo marrëdhënie me Institucionin ku është transferuar punonjësja, që është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Nga verifikimet e kryera në lidhje me këtë rast, konstatohet se akti i transferimit nga ana e DAP, ka dalë në datën 29.12.2017, ndërsa akti i emërimit në DPD, ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezën e punës, e për pasojë edhe nuk është paguar për këtë periudhë, çka pranohet edhe nga MFE, në përgjigje të një kërkesë që është dërguar nga ankuesja për të rregulluar situatën ligjore.

Në kushtet kur provohet se, realisht në marrëdhënien e punës së ankueses ***** ka një ndërprerje prej 15 ditësh (*e verifikuar kjo edhe në listë pagesë dhe në listë prezencën e institucioneve të përfshira në këtë proces, MFE dhe DPD*), e cila nuk është e justifikuar në asnjë rast në ligj apo në akte nënligjore, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duhet të marrin masat për të rregulluar këtë aspekt paligjshmërie, për të rivendosur të drejtën e nëpunësit në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar këtë periudhë në librezën e punës si dhe duke e llogaritur si vjetërsi në shërbimin civil si dhe të pagës për punën e kryer, duke i paguar detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.

➤ Ankesat drejtuar Institucionit në lidhje me ndërprerjen e pagës për një periudhë 15 ditore, nga punonjësit:

2. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit, në datën 22.02.2018, me të njëjtin objekt, pra ka kërkuar vazhdimin e marrëdhënies financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur kjo marrëdhënie është lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe akti i emërimit në DPT, ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezën e punës.

Në kushtet kur provohet se realisht, në marrëdhënien e punës së ankuesit ***** ka një ndërprerje prej 15 ditësh (*e verifikuar kjo edhe në listë pagesë dhe në listë prezencën e institucioneve të përfshira në këtë proces, MFE dhe DPT*), e cila nuk është e justifikuar në asnjë rast në ligj apo në akte nënligjore, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duhet të marrin masat për të rregulluar këtë aspekt paligjshmërie, për të rivendosur të drejtën e nëpunësit në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar këtë periudhë në librezën e punës si dhe duke e llogaritur si vjetërsi në shërbimin civil si dhe të pagës për punën e kryer, duke i paguar detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.

3. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me të njëjtin objekt, pra vazhdimin e marrëdhënies financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur kjo marrëdhënie është lidhur me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën

29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, i janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezën e punës.

4. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me të njëjtin objekt, pra vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur marrëdhënia është lidhur me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.
5. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me të njëjtin objekt, pra vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur këto marrëdhënie janë lidhur në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhënia me MF, është ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.
6. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me të njëjtin objekt, pra vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur ato janë lidhur në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.
7. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me të njëjtin objekt, pra vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur këto marrëdhënie janë lidhur në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.
8. ***** ka paraqitur një ankesë pranë institucionit në datën 26.01.2018, me objekt, vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur këto marrëdhënie janë lidhur në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.

9. ***** ka paraqitur një ankesë në datën 26.01.2018, me objekt, vazhdimin e marrëdhënieve financiare nga Ministria e Financave, deri në datën kur këto marrëdhënie janë lidhur në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Akti i transferimit i DAP, ka dalë në datën 29.12.2017 dhe marrëdhëniet me MF, janë ndërprerë në datën 01.01.2018, ndërkohë që akti i emërimit në Agjenci ka dalë në datën 16.01.2018, pra ka një mungesë prej 15 ditësh në librezë.

Në kushtet kur provohet se realisht, në marrëdhënien e punës së punonjësve të analizuar më sipër, ka një ndërprerje prej 15 ditësh (*e verifikuar kjo edhe në listë pagesë dhe në listë prezencën e institucioneve të përfshira në këtë proces, MFE dhe ASHZHI*), e cila nuk është e justifikuar në asnjë rast në ligj apo në akte nënligjore, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, duhet të marrin masat për të rregulluar këtë aspekt paligjshmërie, për të rivendosur të drejtën e nëpunësve në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar këtë periudhë në librezën e punës si dhe duke e llogaritur si vjetërsi në shërbimin civil, si dhe të pagës për punën e kryer, duke i paguar detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.

10. ***** ka bërë ankesë administrative në lidhje me transferimin e saj nga pozicioni Specialist kategoria III-b, në kategorinë IV-a, në Drejtorinë e Metrologjisë dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 3003/1, datë 12.03.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm, me të cilën ankuesja ka qenë dakord, pasi nuk ka vijuar më tej ankimi.

Në këtë rast, vlerësojmë se, dispozitat që rregullojnë institutin e ristrukturimit, kur për shkak ristrukturimi pozicioni i punës nuk ekziston më, apo nuk përmban karakteristikat e mëparshme, shprehen vetëm për detyrimin e njësisë përgjegjëse, për *ruajtjen e kategorisë së pozicionit* të punës, sipas konceptimit që i bën këtij elementi të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pika 2, e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në këtë vështrim, në rastin e transferimit për shkak të ristrukturimit të pozicionit të punës, të një nëpunësi civil të kategorisë ekzekutive, sipas ligjit, ekziston detyrimi që pozicioni i ri i punës ku do të transferohet, të jetë gjithashtu pozicioni i kategorisë ekzekutive, pa u lidhur me ndonjë detyrim të një natyre tjetër, si paga, kushtet e punës, etj.

Problemi i pagesës dhe niveleve të pagës, rregullohet nga neni 34, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në pikën 2 të tij, përcaktohen përbërësit e pagës: “Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë e kategorisë, shtesa për klasën së cilës i përket pozicioni, dhe shtesa për kushtet e punës” dhe në pikën 4, të po këtij neni, përcaktohet kompetenca e organit që përcakton strukturën dhe nivelin e pagës për çdo pozicion. Në “të thuhet shprehimisht: “Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave sipas këtij neni”, kompetencë e cila materializohet, për çdo rast dhe institucion, nëpërmjet urdhrave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.

Ky është kuptimi që i jep ligji detyrimeve të institucionit për ruajtjen e statusit të nëpunësve civilë, në rastet kur pozicionet e tyre preken nga ristrukturimi. Nisur nga parimi kushtetues, i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, kuptohet që një nëpunës, kur pranon të punojë në një pozicion pune të shërbimit civil, qoftë në momentin e pranimit në shërbimin civil, ashtu dhe

në rastin e transferimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, për shkaqe ligjore, është i detyruar të marrë parasysh që, do të paguhet sipas pagës së përcaktuar nga organi kompetent për atë pozicion pune.

Organi kompetent për përcaktimin e pagës për pozicionet e punës është Këshilli i Ministrave, i cili nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave, të cilat siç u tha dhe më lart, materializohen nëpërmjet urdhrave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagës për çdo institucion dhe pozicion konkret pune.

Gjithashtu, nga verifikimet e realizuara në subjekt, si dhe nga informacioni i kërkuar prej institucionit, sipas të dhënave të Sektorit të Oponencës Ligjore, rezulton se disa punonjës të këtij institucioni, i janë drejtuar me ankesë, gjykatës administrative, respektivisht si më poshtë:

- ✓ *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me kërkesë padi për anulimin e aktit të transferimit dhe aktualisht gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Vijon procesi në nivelet e tjera të gjykimit.
- ✓ *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesë padi për anulimin e aktit të transferimit dhe aktualisht gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Vijon procesi në nivelet e tjera të gjykimit
- ✓ *****, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesë padi për anulimin e aktit të transferimit dhe aktualisht gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Vijon procesi në nivelet e tjera të gjykimit.
- ✓ *****, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë në datën 19.02.2018 . Çështja në këtë rast është duke u shqyrtuar nga gjykata dhe do të zgjidhet në themel prej saj në zbatim të nenit 41, të ligjit për nëpunësin civil.

Rezulton se këta punonjës aktualisht janë në marrëdhënie punë në institucione që përfshihen në shërbimin civil, pasi e kanë pranuar pozicionin përkatës, me përjashtim të punonjësit *****, i cili ka kaluar në pritje, për shkak se është TND.

h) Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit

Në strukturat dhe organikat e gjithë ministrive të cilat janë miratuar me urdhër të kryeministrit, nuk ekziston më asnjë njësi organizative e dedikuar për realizimin e funksioneve të menaxhimit TIK.

Në strukturën e re të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, miratuar me urdhrin nr. 177 datë 10.10.2017, është parashikuar nga një njësi organizative për realizimin e funksioneve të menaxhimit TIK, për ministrinë e linjës.

Për sa më sipër duke qenë se marrëdhëniet e punës për punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, komisioni i

ristrukturimit vendosi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësit drejtorive të IT, konkretisht si më poshtë:

Ministria e Financave në strukturën e saj dhe organikën e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 8, datë 31.01.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave” kishte në përbërje edhe “Drejtorinë e Sistemeve të Informacionit”, kishte gjithsej **13** pozicione në shërbimin civil, me një ndarje si më poshtë:

1. Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **1** pozicion pune
2. Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues - **3** pozicione pune
3. Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive – **9** pozicione pune

Janë shqyrtuar nga Komisioni i Ristrukturimit dhe kanë përfunduar marrëdhënien me shërbimin civil **11** punonjës.

Për sa i përket punonjësës *****, pozicioni i punës "Drejtor në Drejtorinë e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit", rezulton se ka bërë kërkesë personale për pezullim nga shërbimi civil, miratuar me aktin nr. 15418/4 datë 04.12.2017.

Ndërsa punonjësja ***** pozicioni i punës "Përgjegjës Sektori në Sektorin e Help-Desk-ut", në Drejtorinë e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, është liruar nga shërbimi civil me dorëheqje, vërtetuar me aktin nr. 12699/2, datë 21.09.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në strukturën dhe organikën së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 106, datë 24.06.2016, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 136, date 23.08.2016, kishte në përbërje edhe “Drejtorinë e Sistemeve të Informacionit” gjithsej **7** pozicione në shërbimin civil (në momentin e ristrukturimit ishin **3** vende të lira), me një ndarje si më poshtë:

1. Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **1** pozicion pune
2. Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues - **2** pozicione pune
3. Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive – **4** pozicione pune

Janë shqyrtuar nga Komisioni i Ristrukturimit dhe kanë përfunduar marrëdhënien me shërbimin civil **4** punonjës (pasi **3** pozicione pune kanë qenë të lira).

Në lidhje me pozicionet, ku këta nëpunës kanë qenë të emëruar, grupi i punës konstaton se në strukturën aktuale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk është parashikuar njësia organizative e teknologjisë së informacionit, për arsye se, në zbatim të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, strukturat përgjegjëse TIK në institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Në pikën 23, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në këto institucione, kalojnë tek AKSHI, brenda datës 23.12.2013 dhe këta nëpunës trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës.

Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri vëren se, vendimet e Komisionit të Ristrukturimit, për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në rastin e nëpunësve të analizuar më sipër, janë marrë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Rezulton se, në aktin e lirimimit nga shërbimi civil, nëpunësve të mësipërm, u është njohur e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë e punës, si e drejtë e përcaktuar në nenin 50, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me qëllim garantimin e të drejtave të këtyre punonjësve, të liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duke kërkuar fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e mësipërm, sipas përcaktimeve të aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt.

i) Konkluzione dhe rekomandime:

Nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar në këtë rast, arrin në konkluzionin dhe vlerëson se, për të rregulluar aspekte të veçanta të parregullsive të konstatuara gjatë monitorimit, nga ana e institucioneve të ngarkuara prej ligjit për të menaxhuar procesin e ristrukturimit, duhet të veprohet si më poshtë:

1. Të përfundojë menjëherë hartimi i përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 31.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse, që në këtë rast është Departamenti i Administratës Publike.

2. Në lidhje me punonjësen *****, e cila i është drejtuar me ankesë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për arsyet që janë analizuar në përmbajtjen e raportit të monitorimit, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duhet të marrin masat për të rregulluar aspektin e paligjshmërisë dhe të rivendosin të

drejtën e nëpunësit në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar periudhën e munguar prej 15 ditësh, në librezën e punës, si dhe të llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil. Po kështu, të rivendoset ligjshmëria në drejtim të pagimit të pagës për punën e kryer, duke i paguar ankueses detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.

3. Në lidhje me punonjësin *****, i cili i është drejtuar me ankesë institucionit, për të kërkuar respektimin e të drejtave të nëpunësit civil, për arsyet që janë analizuar në përmbajtjen e raportit të monitorimit, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, duhet të marrin masat për të rregulluar aspektin e paligjshmërisë dhe të rivendosin të drejtën e nëpunësit në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar periudhën e munguar prej 15 ditësh, në librezën e punës, si dhe të llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil. Po kështu, të rivendoset ligjshmëria në drejtim të pagimit të pagës për punën e kryer, duke i paguar ankueses detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.
4. Në lidhje me punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët i janë drejtuar me ankesë institucionit, për të kërkuar respektimin e të drejtave të nëpunësit civil, për arsyet që janë analizuar në përmbajtjen e raportit të monitorimit, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, duhet të marrin masat për të rregulluar aspektin e paligjshmërisë dhe të rivendosin të drejtën e nëpunësve në lidhje me vijimësinë e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e shënuar periudhën e munguar prej 15 ditësh, në librezën e punës, si dhe të llogaritet si vjetërsi në shërbimin civil. Po kështu, të rivendoset ligjshmëria në drejtim të pagimit të pagës për punën e kryer, duke i paguar ankuesve detyrimin përkatës për periudhën që i është ndërprerë.
5. Për sa i përket ankesave të punonjësve që i janë drejtuar gjykatës, *****, *****, ***** dhe *****, Komisioneri vlerëson se ato do të marrin zgjidhje përfundimtare nga Gjykata Administrative, e cila është organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative që lindin gjatë një marrëdhënieje pune në shërbimin civil, në zbatim të nenit 41, të ligjit për nëpunësin civil.
6. Njësia përgjegjëse të informojë Komisionerin në vijimësi për çdo veprim që do të realizohet në lidhje me detyrat e lëna, pasi ky proces do të ndiqet dhe asistohet nëpërmjet Sekretariatit që mbështet veprimtarinë e Komisionerit, me qëllim që të rivendoset ligjshmëria për aspektet e konstatuara si parregullsi gjatë aplikimit të procesit të ristrukturimit.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në këtë Raport, për të finalizuar sa më shpejt procesin e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, me qëllim përmirësimin e situatës si dhe të rivendoset ligjshmëria për aspektet e konstatuara si parregullsi gjatë aplikimit të procesit të ristrukturimit.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha